



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 487/19
488/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi -Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik: z. Muharrem Hoti B.I– (NTSH.”Leoni”)- Malishevë, me nr. 487/19, dhe OE NPSH “AFA ING” – Suharekë, me nr. 488/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për dhënie të kontratës: OE “INTER ADRIA” LLC-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën 30.08.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuara ankesa e operatorit ekonomik: z. Muharrem Hoti B.I– (NTSH.”Leoni”)- Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/– Kuvendi i Komunës së Prishtinës .

II. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “AFA ING” – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/– Kuvendi i Komunës së Prishtinës .

III. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/– KK Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues z. Muharrem Hoti B.I– (NTSH. "Leoni")- Malishevë, aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa, aprovohet pjesërisht si e bazuara ankesa e operatorit ekonomik ankues "NPSH "AFA ING"– Suharekë dhe të njëjtit i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e publikimit të njoftimit për kontratë është bërë me dt: 16.04.2019.

Data e publikimit të njoftimit për korrigjimin e gabimeve është bërë me dt: 03.05.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 14.05.2019.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë me dt: 21.06.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim (AFA ING) është bërë me dt: 26.06.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 26.07.2019.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së (pas rishqyrtimit) është bërë me dt: 22.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim (Muharrem Hoti BI) është bërë me dt: 26.07.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 29.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim (AFA ING) është bërë me dt: 28.07.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 30.07.2019.

Operatori ekonomik ankues: z. Muharrem Hoti B.I– (NTSH. "Leoni")- Malishevë, me nr. 487/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me date: 06.08.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore", me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar se.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 paragrafi 4, dhe 60 paragrafi 1.1, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues: "NPSH "AFA ING"- Suharekë, me nr. 488/19, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me date 06.08.2019, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi i kamerave në institucionet arsimore", me nr. të prokurimit: 616-19-1959-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar se.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 13, 28, 59, dhe 108/A pika 8.2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 40 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 19.08.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin e jashtëm teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, në raportin e datës: 21.08.2019, kanë sqaruar pretendimet e OE ankues, z. Muharrem Hoti B.I- (NTSH."Leoni")- Malishevë, me nr. 487/19 dhe OE - NPSH "AFA ING" Suharekë me nr. 488/19.

Sqarim hyrës - Autoriteti Kontraktues/Kuvendi i Komunës së Prishtinës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës.

Përgjigjeje për pretendimet e OE ankues z. Muharrem Hoti B.I- (NTSH."Leoni")- Malishevë, me nr. 487/19 .

Pretendimi ankimor: OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje duke vlerësuar si të përgjegjshme tenderin e OE të rekomanduar për kontratë për kundër që nuk ka plotësuar specifikimet në kolonën C për 12 pozicione ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

Sqarim: AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka kërkuar specifikisht që për tabelën ku janë vendosur specifikimet teknike, “Kolona (c) është obligative që të plotësohet nga Operatori Ekonomik”. Në kolonën C, AK ka precizuar që OE duhet të paraqesin “specifikacionin e ofruar (duke përfshirë modelin)”.

Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Inter Adria LLC) , është dorëzuar dokumenti “ Oferta Teknike”, ku është paraqitur tabela me specifikimet teknike të kërkuara dhe kolonën C të plotësuar me specifikimet teknike dhe modelet për pozicionet 1,2 dhe 3. Pra mungojnë pozicionet 4 deri në 6, rrjedhimisht mungon përshkrimi i specifikimeve dhe modeli ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

Andaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Përgjigjeje për pretendimet e OE ankues NPSH “AFA ING”- Suharekë me nr. 488/19.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP, pasi që pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues me datë 26.06.2019, ka bërë rivlerësim ku ka dal jashtë pretendimeve ankimore duke e rivlerësuar tenderin e OE ankues dhe rrjedhimisht shpallur të papërgjegjshme.

Sqarim: AK me datë 21.06.2019, ka nxjerr vendim ku njofton se OE “Muharrem Hoti” B.I - Malishevë , shpërblehet me kontratë, dhe përmes letrës standard për tenderuesi e pasuksesshëm, OE ankues dhe 5 OE tjerë i ka njoftuar se tenderi nuk që i suksesshëm pasi që tenderi juaj nuk është me çmimin më të ulët. OE ankues me datë 26.06.2019 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së kundrejt vendimit të AK-së për dhënie të kontratës, ku ka pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë dhe dy OE tjerë nuk I plotësojnë kërkesat për tenderë.

Në të njëjtën ditë AK ka nxjerr vendimin për aprovim të pjesërishtë të kërkesë. Në arsyetimin e vendimit, AK ka saktësuar se nga tre pretendime ankimore, vetëm njëri është i qëndrueshëm. Megjithatë pretendimi ankimor kundrejt të rekomanduarit për kontratë është cilësuar si i pabazuar. Në fund të vendimit rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim.

Me datë 22.07.2019 AK ka nxjerr njoftim mbi vendimin pas rivlerësimit, ku ka shpërblyer me kontratë OE INTERADRIA. Më tej AK përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, ka njoftuar OE ankues se tenderi është i papërgjegjshëm për shkak se “ te pozicioni 2 është kërkuar 2.7 – 12mm Motorized lens2.7-12mm ndërsa është ofertuar -3.6mm (2.8mm, 6mm, 8mm fixed lens).

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje te nenit 28 dhe nenit 59 te LPP, pasi qe arsyeja e eliminimit është e paqëndrueshme.

Sqarim: AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, në specifikimet teknike, për pozicionin 2 ka kërkuar “2.7 – 12mm Motorized lens”.

Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues, në tabelën me specifikimet teknike është precizuar se OE ankues oferton me modelin HAC-HFW1500TL-A për pozicionin 2. Gjithashtu në mes tjera specifikohet se OE ofron “3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm, 8mm optional)”. Pajisja e ofertuar nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit nga AK, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i paqëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/Teknik

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që:

a) ankesa e OE ankues - “Muharrem Hoti” B.I,të aprovohet si e bazuar ,

b) ankesa e OE ankues - “AFA-ING” NPSH, të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht, rekomandohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë:27.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik z.Muharrem Hoti B.I– (NTSH.”Leoni”)- Malishevë, me datë: 27.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “AFA-ING” NPSH Suharekë, me datë: 27.08.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.08.2019, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankuese, përfaqësuesi i AK-së, si dhe eksperti shqyrtues teknik, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesat e operatoreve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z.Muharrem Hoti B.I– (NTSH.”Leoni”)- Malishevë, z. Hoti deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të gjitha pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ana e eksperteve dhe konsiderojmë se në mënyrë profesionale dhe nuk kam tjetër të shtoj.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së “AFA-ING” NPSH Suharekë, z. Morina deklaroj: Ne si OE pajtohemi pjesërisht me mendimin ekspertit pasi që me datën 22.07.2019 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim Autoriteti Kontraktues kërkesën tonë e ka aprovuar pjesërisht të bazuar decidivisht gjatë rivlerësimit të Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A konkretisht pikën 8.2 decidivisht 8.4 Cito” Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptim të asaj që kuptohet nga ankuesi” i ka tejkaluar pretendimet tona për rishqyrtim, në këtë rast nuk na kanë kaluar neve por ena kanë kaluar dhe për këtë pikë nuk pajtohemi. Sa i përket punës së kamerës që kemi ofruar është kompatible.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Latifi deklaroj: Fillimisht deshtë të falënderoj Ekspertin e IT-se ku teknikisht ka qenë në rregullt por ne nuk pajtohemi për arsye të tjera që tani do të e laburojmë tani.

Me OE “Afa Ing” Nuk e ka plotësuar është kërkuar objektiv moterized dhe ky nuk e ka ofruar, herën e parë Afa Ing i ka plotësuar kriteret por tender është hyr në rishqyrtim dhe është shikuar dhe për herën e dytë nuk i plotëson kushtet. Arsyetimin që e ka dhenë se Enviari e përkrahë që nuk ka të bëjë fare dhe ku kompania nuk ia qëllon hiq dhe nuk janë profesionale si kompani.

Për OE “Muharremi” B.I. Eksperti ka thënë që nuk është plotësuar kolona C, një kohësisht në pas vlerësimit të tenderit në e rishqyrtojmë me anëtarë e prokurimi, ata kanë thënë a kanë ofruar katalog shtesë dhe nuk ka qenë i detyrueshëm katalogu por kompanitë e përgjegjshme që i ofrojnë katalogët. Shumica e ofertuesve nuk kanë ditë të plotësojnë Kolonën C, dhe ne kemi thënë nuk kemi të drejtë të eliminojmë për këtë pikë. OE “Muharrem Hoti” nuk i ka plotësuar këto pika p.sh: Kërkesë ka qenë Kolona C dhe nuk e ka plotësuar këtë kriter.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti i jashtëm teknik z. Spahiu deklaroj: Eksperti teknik deklaron se qëndron pranë raportit të ekspertizës dhe rekomandimit që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim. Fillimisht në lidhje me pretendimet ankimore të OE “Muharrem Hoti” B.I, sqarojmë:

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje duke vlerësuar si të përgjegjshme tenderin e OE të rekomanduar për kontratë përkundër që nuk ka plotësuar specifikimet në kolonën C për 12 pozicione ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

AK ka kërkuar specifikisht që për tabelën ku janë vendosur specifikimet teknike, “Kolona (c) është obligative që të plotësohet nga Operatori Ekonomik”. Ndërsa në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Inter Adria LLC) , është dorëzuar dokumenti “ Oferta Teknike”, ku është

paraqitur tabela me specifikimet teknike të kërkuara dhe kolonën C të plotësuar me specifikimet teknike dhe modelet për pozicionet 1,2 dhe 3. Pra mungojnë pozicionet 4 deri në 6, rrjedhimisht mungon përshkrimi i specifikimeve dhe modeli ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit. Andaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Ndërsa në lidhje me pretendimet e OE - NPSH "AFA ING" sqarojmë

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP, pasi që pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues me datë 26.06.2019, ka bërë rivlerësim ku ka dal jashtë pretendimeve ankimore duke e rivlerësuar tenderin e OE ankues dhe rrjedhimisht shpallur të papërgjegjshme.

AK me datë 21.06.2019, ka nxjerr vendim ku njofton se OE "Muharrem Hoti" B.I - Malishevë , shpërblehet me kontratë, dhe përmes letrës standard për tenderuesi e pasuksesshëm, OE ankues dhe 5 OE tjerë i ka njoftuar se tenderi nuk qe i suksesshëm pasi që tenderi juaj nuk është me çmimin me të lartë. OE ankues me datë 26.06.2019 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së kundrejt vendimit të AK-së për dhënie të kontratës, ku ka pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë dhe dy OE tjerë nuk i plotësojnë kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Në të njëjtën ditë AK ka nxjerr vendimin për aprovim të pjesërishtë të kërkesë. Në arsyetimin e vendimit, AK ka saktësuar se nga tre pretendime ankimore, vetëm njëri është i qëndrueshëm. Megjithatë pretendimi ankimor kundrejt të rekomanduarit për kontratë është cilësuar si i pabazuar. Në fund të vendimit rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim.

Me datë 22.07.2019 AK ka nxjerr njoftim mbi vendimin pas rivlerësimit, ku ka shpërblyer me kontratë OE INTERADRIA. Më tej AK përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, ka njoftuar OE ankues se tenderi është i papërgjegjshëm për shkak se " te pozicioni 2 është kërkuar 2.7 – 12mm Motorized lens2.7-12mm ndërsa është ofertuar -3.6mm (2.8mm, 6mm, 8mm fixed lens)".

Më tej OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje te nenit 28 dhe nenit 59 te LPP, pasi qe arsyeja e eliminimit është e paqëndrueshme. AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, në specifikimet teknike, për pozicionin 2 ka kërkuar "2.7 – 12mm Motorized lens". Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues, në tabelën me specifikimet teknike është precizuar se OE ankues oferton me modelin HAC-HFW1500TL-A për pozicionin 2. Gjithashtu në mes tjera specifkohet se OE ofron "3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm, 8mm optional)". Pajisja e ofertuar nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit nga AK, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i paqëndrueshëm.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Hoti deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Morina deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si plotësisht të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Latifi deklaroj: Kërkojmë të hedhen poshtë ankesat e OE-ve Ankuese dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik të prokurimit konstaton si më poshtë:

Në vazhdim paneli shqyrtues jep përgjigjet lidhur me ankesën e OE ankues, z. Muharrem Hoti B.I- (NTSH. "Leoni")- Malishevë, me nr. 487/19.

Lidhur me pretendimin ankimor ku OE ankues ku pretendon se AK ka bërë shkelje duke vlerësuar si të përgjegjshme tenderin e OE të rekomanduar për kontratë për kundër që nuk ka plotësuar specifikimet në kolonën C për 12 pozicione ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

Sqarim: AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ka kërkuar specifikisht që për tabelën ku janë vendosur specifikimet teknike, "Kolona (c) është obligative që të plotësohet nga Operatori Ekonomik". Në kolonën C, AK ka precizuar që OE duhet të paraqesin "specifikacionin e ofruar (duke përfshirë modelin)".

Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Inter Adria LLC) , është dorëzuar dokumenti " Oferta Teknike", ku është paraqitur tabela me specifikimet teknike të kërkuara dhe kolonën C të plotësuar me specifikimet teknike dhe modelet për pozicionet 1,2 dhe 3. Pra mungojnë pozicionet 4 deri në 6, rrjedhimisht mungon përshkrimi i specifikimeve dhe modeli ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve të ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik të prokurimit konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Në vazhdim paneli shqyrtues jep përgjigjet lidhur me ankesën e OE ankues, NPSH “AFA ING”-Suharekë me nr. 488/19.

Lidhur me pretendimin ankimor ku OE ankues ku pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP, pasi që pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues me datë 26.06.2019, ka bërë rivlerësim ku ka dal jashtë pretendimeve ankimore duke e rivlerësuar tenderin e OE ankues dhe rrjedhimisht shpallur të papërgjegjshme.

Sqarim: AK me datë 21.06.2019, ka nxjerr vendim ku njofton se OE “Muharrem Hoti” B.I - Malishevë , shpërblehet me kontratë, dhe përmes letrës standard për tenderuesi e pasuksesshëm, OE ankues dhe 5 OE tjerë i ka njoftuar se tenderi nuk që i suksesshëm pasi që tenderi juaj nuk është me çmimin më të ulët. OE ankues me datë 26.06.2019 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së kundrejt vendimit të AK-së për dhënie të kontratës, ku ka pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë dhe dy OE tjerë nuk I plotësojnë kërkesat për tenderë.

Në të njëjtën ditë AK ka nxjerr vendimin për aprovim të pjesërishëm të kërkesë. Në arsyetimin e vendimit, AK ka saktësuar se nga tre pretendime ankimore, vetëm njëri është i qëndrueshëm. Megjithatë pretendimi ankimor kundrejt të rekomanduarit për kontratë është cilësuar si i pabazuar. Në fund të vendimit rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim.

Me datë 22.07.2019 AK ka nxjerr njoftim mbi vendimin pas rivlerësimit, ku ka shpërblyer me kontratë OE INTERADRIA. Më tej AK përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, ka njoftuar OE ankues se tenderi është i papërgjegjshëm për shkak se “ te pozicioni 2 është kërkuar 2.7 – 12mm Motorized lens 2.7-12mm ndërsa është ofertuar -3.6mm (2.8mm, 6mm, 8mm fixed lens).

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje te nenit 28 dhe nenit 59 te LPP, pasi qe arsyeja e eliminimit është e paqëndrueshme.

Sqarim: AK në dosjen e tenderit, përkatësisht tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, në specifikimet teknike, për pozicionin 2 ka kërkuar “2.7 – 12mm Motorized lens”.

Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues, në tabelën me specifikimet teknike është precizuar se OE ankues oferton me modelin HAC-HFW1500TL-A për pozicionin 2. Gjithashtu në mes tjera specifikohet se OE ofron “3.6mm fixed lens (2.8mm, 6mm, 8mm optional)”. Pajisja e ofertuar nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në dosjen e tenderit nga AK, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik te prokurimit konstaton se pretendimi ankimor për këtë pikë është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës
- 1x1 z. Muharrem Hoti B.I– (NTSH. "Leoni")- Malishevë
- 1x1 NPSH "AFA ING", Suharekë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.